



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.23, datë 28.02.2020

PËR
“PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE QË DO TË NDIQEN NGA AUTORITETET E
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE, BREND
ZONËS SË BREZIT BREGDETAR”

I azhurnuar me:

- ***Vendimin e KKT-së Nr.40, datë 03.12.2020***

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar; si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Brenda zonës së brezit bregdetar sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të miratojnë leje zhvillimi/ ndërtimi/ prishje/ rikonstruksion/ riparime/ shtesa/ ndryshim projekti gjatë ndërtimit/ ndryshim të subjekteve zhvilluese **dhe ndryshim i aktiviteteve/ funksioneve/** shtyrje afati dhe çdo leje tjetër të përmendur në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit, si dhe të kryejnë procedurat administrative për të gjithë aktet/dokumentet përkatëse, të parashikuara në legjisllacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, deri në lëshimin e çertifikatës së përdorimit, vetëm për këto raste përjashtimore:
 - a) objekte të reja me sipërfaqe të përgjithshme deri në 250 m²;
 - b) objekte të cilat kanë leje ndërtimi të miratuara nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit para hyrjes në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.693, datë 02.10.2019, pavarësisht nga sipërfaqja e përgjithshme e tyre;

- c) rrjetet infrastrukturës publike vendore dhe objektet shtetërore në pronat shtetërore të transferuara tek njësitë e qeverisjes vendore;
 - d) objektet e dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, infrastruktura publike dhe/ose kritike, si dhe ndërtime të reja në zonat e ndëmtuara nga fatkeqësia natyrore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.887, datë 24.12.2019.
 - e) rrjetet e fibrave optike;
 - f) muret rrethuese.
2. Autoritetet vendore të zhvillimit të territorit duhet të vijojnë procedurat në përputhje me kushtet dhe rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit, për të gjitha rastet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, me përjashtim kur kërkohet miratimi i një leje zhvillimi apo leje ndërtimi, për objekte të reja, për të cilat duhet të ndjekin procedurën e mëposhtme:
- a) autoriteti vendor i drejton Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, kërkesën për marrjen e konformitetit, së bashku me dokumentacionin shoqërues të poshtëshënuar:
 - i. Dokumentacioni i plotë i pronësisë;
 - ii. Planvendosja e objektit;
 - iii. Projekti arkitektonik.
 - b) Agjencia e Zhvillimit të Territorit, i përgjigjet autoritetit vendor të zhvillimit të territorit, në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga marrja e kërkesës përkatëse;
 - c) pas marrjes së njoftimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për konformitetin e zhvillimit të propozuar, autoriteti vendor vijon procedurën për miratimin e lejes përkatëse.
3. Për të gjitha rastet e tjera, të cilat nuk përfshihen në pikën 1, të këtij vendimi, autoriteti kompetent vendimmarrës brenda zonës së brezit bregdetar, është Këshilli Kombëtar i Territorit.
- 3/1. Kërkesat për kryerjen e punimeve mbi bazën e një “deklarate paraprake për kryerjen e punimeve”, do të paraqiten dhe shqyrtohen pranë autoriteteve vendore të zhvillimit të territorit, me përjashtim të kërkesave për stacione plazhi, të cilat janë objekt i një leje ndërtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit.”
4. Për objektet jashtë zonës së brezit bregdetar, por brenda zonave të rëndësishme kombëtare, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit duhet të vijojnë procedurat për shqyrtimin e

kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi brenda zonave të rëndësisë kombëtare, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.17, datë 07.06.2016 “Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi brenda zonave të rëndësisë kombëtare”.

5. Harta e planvendosjes së zonës së brezit bregdetar, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të gjitha autoritetet e zhvillimit në nivel vendor, për ndjekjen dhe zbatimin e tij.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA